



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

në mes të:

KOMUNËS së ULQINIT

dhe

PROKURORISË THEMELORE SHETËRËRE - ULQIN

GJYKATËS THEMELORE - ULQIN

ZYRËS SË POLICISË - ULQIN

QENDRËS PËR PUNË SOCIALE

(Njësia rajonale Ulqin)

SHTËPIA E SHËNDETIT - ULQIN

OJQ "HORIZONT I RI" - Ulqin

Duke besuar se bashkëpunimi i pushtetit vendor, institucioneve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile, sjellë bashkimin e potencialeve të tyre dhe rezulton me projekte të dobishme për qytetarët e komunës së Ulqinit;

Mbështetur në përvojat pozitive të bashkëpunimit të deritanishëm dhe

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes së të rinjve për dëmet e abuzimit me droga, zvogëlimin e shkallës së sjelljeve delikuede dhe të papranueshme në mesin e të rinjve në komunitetin lokal, si dhe të forcimit të kapaciteteve të Zyrës lokale për parandalimin e narkomanisë,

palët nënshkruese të Memorandumit pajtohen që:

- ✓ do të sigurojnë realizimin e bashkëpunimit në çështjet e edukimit të fëmijëve dhe të rinjve, shkëmbimit të njohurive dhe përvojave, parandalimit të narkomanisë, sjelljeve të papranueshme dhe dukurive të tjera negative në komunitetin lokal;
- ✓ do të delegojnë përfaqësuesit e vet profesionistë për pjesëmarrje në aktivitetet e mëposhtëme:
 - Trajnimi i edukatorëve për luftimin e drogave dhe sëmundjeve të varësisë,
 - Hartimin e udhëzuesit special “FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN”,
 - Paraqitje mediatike dhe ngjarje publike,
 - Hartimin e Planit Lokal të Veprimit për parandalimin e narkomanisë dhe kriminalitetit të të miturve

Memorandumi nënshkruhet në frymën e partneritetit dhe të besimit të ndërsjellët.
Memorandumi hynë në fuqi ditën që nënshkruhet dhe lidhet në kohë të pacaktuar.

Ulcinj, 18.11.2015.


OPŠTINA ULCINJ


OSNOVNI SUD ULCINJ


OSNOVNO DRŽAVNO TUŽILAŠTVO
ULCINJ


ISPOSTAVA POLICIJE ULCINJ


CENTAR ZA SOCIJALNI RAD
Područna jedinica Ulcinj


DOM ZDRAVLJA ULCINJ


NVO "NOVI HORIZONT"